



MISIONI SHQIPTAR

*Shën Nënë Tereza*

Saint Mother Teresa Albanian Mission  
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7  
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382  
[www.misioninenetereza.com](http://www.misioninenetereza.com)

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

## Jezusi dergoi dy nxenes

9 Prill 2017



Kur iu afruan Jerusalemit e mbërritën në Betfage, në malin e Ullinjve, atëherë Jezusi dërgoi dy nxënës e u tha: “Shkoni në fshat që është kundruall! Aty menjëherë do të gjeni një gomare të lidhur e me të një gaç. Zgjidhni e m’i sillni! Nëse ndokush ju thotë gjë, thoni: ‘Po i duhen zotërisë’, dhe menjëherë do t’i lëshojë.” Ndodhi kështu që të shkonte në vend fjala e profetit që thotë: “Thoni qytetit Sion: Ja, Mbreti yt po vjen te ti i butë, kalor mbi gomare e mbi gaç, zog të gomares”. Nxënësit shkuan e bënë siç u urdhëroi Jezusi, sollën gomarin e kërriçin. Mbi ta vunë petkat e veta, e Jezusi hypi mbi to. Moria e popullit shtroi petkat e veta gjatë rrugës e tjerët thenin degë lisash dhe i qitnin rrugës, e populli, që shkonte para e pas tij, brohoriste: “Hosana Birit të Davidit! Bekuar qoftë ai që vjen në Emër të Zotit! Hosana në qiejt më të lartat!” Kur Jezusi hyri në Jerusalem, mbarë qyteti u çua në këmbë dhe pyeste: “Kush është?” E turma i përgjigjej: “Ky është Profeti, Jezusi prej Nazaretit të Galileës!” Mt 21, 1-11

## Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 PM te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke, M8W 3V7** (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: [www.ourladyofmm.com](http://www.ourladyofmm.com)

## Kalendari liturgjik...

|          |                           |
|----------|---------------------------|
| 10 Prill | Shen Magdalena            |
| 11 Prill | Shen Stanislau ipeshkev   |
| 13 Prill | <b>E Enjtja e Madhe</b>   |
| 14 Prill | <b>E Premtja e Madhe</b>  |
| 15 Prill | <b>E Shtuna e Madhe</b>   |
| 16 Prill | <b>E Diela e Pashkeve</b> |

**Te marteve te Shna Ndout Mesha**  
**kremtohet ne oren 7:30pm**

## Te premten e Madhe 14 prill...

Liturgjia e Kremtimit te Mundimeve  
te Krishtit eshte **ne oren 7pm**

## Mesha e Ringjalljes dhe bekimi i bukes...

Mesha e Madhe e Ringjalljes se Krishtit kremtohet **Te shtunen 15 prill** ne mbremje **ne oren 10pm**. Gjate kesaj Meshe behet edhe bekimi i bukes.

**Haku Kishes 2017...** E ka dhene: **Arben Toma**

|         |          |
|---------|----------|
| Aleks   | Coku     |
| Arben   | Toma     |
| Gjergj  | Nikolla  |
| Illir   | Shyti    |
| Kol     | Pepa     |
| Ljuc    | Junçaj   |
| Martin  | Vuktilaj |
| Mhill   | Ftoni    |
| Nikolle | Lumaj    |
| Paulin  | Marku    |

|          |           |
|----------|-----------|
| Pjerin   | Bruçaj    |
| Pjeter & |           |
| Bep      | Dreshaj   |
| Prek     | Gjonaj    |
| Tefe     | Ndoci     |
| Ton      | Vocaj     |
| Valmir   | Gjinaj    |
| Vaso     | Gjuravçaj |

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

## Per Fondin e ndertimit te Kishes ka dhene ...

|                           |       |
|---------------------------|-------|
| Sokol Sterbyci            | 10000 |
| Pjeter&Bep Dreshaj        | 10000 |
| Ton Vocaj                 | 10000 |
| Aleks Coku                | 5000  |
| Elis Bzhetaj              | 5000  |
| Lec Gashaj                | 5000  |
| Luigj Narkaj              | 5000  |
| Luk Gjollaj               | 5000  |
| Paulin Marku              | 5000  |
| Anton Malaj               | 4000  |
| Arben Pepa                | 3000  |
| Luvigj Lallinaj           | 3000  |
| Mirash Lallinaj           | 3000  |
| Nik Biqi                  | 3000  |
| Anton Brunga              | 2500  |
| Albert Berisha            | 2000  |
| Aleks Dragu               | 2000  |
| Altin Miri                | 2000  |
| Artan Vuksani me vellezer | 2000  |
| Dritan Lumaj              | 2000  |
| Edmond Ramaj              | 2000  |
| Martin Vuktilaj           | 2000  |
| Ndok Gjokaj               | 2000  |
| Pjerin Kalaj              | 2000  |
| Prek Gjonaj               | 2000  |
| Shpend Pllumbaj           | 2000  |
| Sokol/Petrit Ujka         | 2000  |
| Tom Prekulaj              | 2000  |
| Lek Selmani               | 1500  |
| Ndue Selmani              | 1500  |
| Anton Shelinaj            | 1000  |
| Arben Therqaj             | 1000  |
| Edi Linadi                | 1000  |
| Erald Islami              | 1000  |

|                          |      |
|--------------------------|------|
| Gezim Lanazi             | 1000 |
| Gjelosh Vushaj           | 1000 |
| Gjergj Gjinaj            | 1000 |
| Gjovalin Melaj           | 1000 |
| Lek Ramaj                | 1000 |
| Mark Ndoci               | 1000 |
| Mhill Ftoni              | 1000 |
| Ndue Kabashi             | 1000 |
| Petrit Ujkaj             | 1000 |
| Prek Spaqi               | 1000 |
| Prel Pushaj              | 1000 |
| Qamil Llashtica          | 1000 |
| Shqiprim Lumi            | 1000 |
| Sokol Noshi              | 1000 |
| Arben Toma               | 500  |
| Dorian Tabaku            | 500  |
| Fatmir Qosaj             | 500  |
| Kol Pepa                 | 500  |
| Lec Ndoj                 | 500  |
| Pal Rrasburgaj           | 500  |
| Sokol Kaçaj              | 500  |
| Pren Prekaj              | 300  |
| Ernesto Ujka (US dollar) | 300  |

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

## Historia e Javës së Madhe të Pashkëve



Java, që i paraprin Pashkëve, qysh nga kohët më të lashta quhet Java e Shenjtë. E vërtetojnë këtë shkrimet e Shën Atanazit, që jetoi në shekullin IV. Në Lindje kjo javë quhej "e Madhe". E kështu quhet prej shekujsh edhe ndër shqiptarë. Quhej e vijon të quhet 'e Madhe' – na shpjegon e Shën Gjon Gojarti – jo pse ka më shumë ditë sesa javët e tjera, as pse i ka ditët më të gjata, por pse në këtë javë Jezu Krishti kreu gjestet më larta".

Duhet sqaruar se në zanafillë, e ndoshta që nga kohët apostolike, kremtoheshin vetëm e Premtja dhe e Shtuna "ditë në të cilat – siç vëren Tertuliani – Kishës ia morën dhëndrrin".

Gjatë këtyre dy ditëve besimtarët agjëronin më shumë se ditëve të tjera e, në shenjë zije, nuk shkëmbehej përqafimi e puthja e paqes. Kremtimi përfundonte me të Dielën e Pashkëve.

Kremtohej kështu Triditshja e Pashkëve, nga e premtja, tek e diela. Në shekullin IV nisën të kremtohen në formë historike ngjarjet që rrëfohen nga Ungjilli, posaçërisht themelimi i Eukaristisë, të enjten. Ky kremtim shënoi një risi në Triditshen e Pashkëve, që nuk zgjatej më nga e premtja tek e diela, por nga e enjtja, tek e shtuna.

Më pas u shtua edhe një ditë tjerë, e mërkura, në kujtim të vendimit që morën judenjtë për ta mbytur Krishtin. Më pas, herë pas here, u shtuan edhe e hënë dhe e marta, aq sa tek shën Atanazi gjejmë porosinë për të agjëruar në mënyrë të posaçme në këto gjashtë ditë shenjte e të mëdha të Pashkëve.

Kjo nuk do të thotë se që në shekullin IV të gjitha ditët e Javës së Madhe patën, në këndvështrimin liturgjik, rëndësinë që morën më pas e që e kanë edhe sot e kësaj dite. Në Lindje ndiqeshin nga populli e nderoheshin shumë më tepër se gjetiu. Kemi dëshmi të lashta për kremtimet e veçanta të Kishës së Jerusalemit. Në Viset e Shenjta, përplot me kujtime tronditëse, nisin të kremtohen liturgji të posaçme, të cilat më pas, pak nga pak, përhapen në perëndim, duke arritur edhe në Romë.

Në Qytetin e Amshuar përveç kremtimit të Eukaristisë, të Enjten e Madhe u shtua edhe rrëfimi i pendestarëve si dhe bekimi i Vajrave të shenjta. Gjithnjë në Romë, të hënë e të martën e Javës së Madhe të Pashkëve, nisi të kremtohej një liturgji e posaçme, e porositur nga Papa Hilari, në shekullin V. Të premtën e të shtunën e Pashkëve, në Romë e në vise të tjera,

nuk u lejua asnjëherë kremtimi eukaristik.

Ritet që kremtohen sot ë Premten e Madhe – adhurimi i Kryqit e Mesha e të parashenjtuarve – hyjnë në liturgjinë romake rreth shekullit VII; e ata të së Shtunës së Madhe, dhe më vonë.



On Palm Sunday, we celebrate the first joy of the season, as we celebrate Our Lord's triumphant entrance into Jerusalem where he was welcomed by crowds worshipping him and laying down palm leaves before him. It also marks the beginning of Holy Week, with the greatest tragedy and sorrow of the year. Jesus' triumphant return to Jerusalem is only one side of the story.

By now many of the Jews are filled with hate for Our Lord. They want to see him stoned, calling Him a blasphemer, especially after offering proof of His Divinity during a winter visit to Jerusalem for the Feast of the Dedication.

After this, Jesus went to Perea, where he was summoned to Bethany. There he raised Lazarus from the dead, a miracle which wins Him such renown among certain Pharisees that they decided finally to end His life.

Jesus took refuge at Ephrem returning six days before Passover to Bethany, triumphantly entering Jerusalem. That evening, He leaves Jerusalem and returns Monday. He spent time with Gentiles in the Temple, and on Wednesday left for the Mount of Olives. Here he foretold the apostles the events of the next several days, including His impending death.

He returned to Jerusalem on Thursday, to share the Last Supper with His apostles. He was subsequently arrested and tried. He was crucified at Calvary on Friday, outside the gates of Jerusalem.

He was buried the same day, and arose three days later, on Easter Sunday.

All of this is done by our Lord for forgiveness of our sins, and for life everlasting with Him.

God so loved us, that He sent His only begotten Son to die for us, so that our sins maybe forgiven.



**L-MULTI  
DRAFTING/DESIGN**

**LEK SELMANI owner**

Tel: (416) 471-0475  
Fax: (647) 345-4126  
E-mail: Lek@Lmultidd.com  
[www.Lmultidd.com](http://www.Lmultidd.com)

JU SHËRBEJMË ME PROJEKTE PËR  
LEJE NDËRTIMI (PERMIT DRAWINGS)  
NË PROJEKTIM THE DETAJIM NDËRTIMI  
PER SHTËPI TË REJA, SHITESË  
SHTËPIJE GARAZHD TË RI, HYRJE  
TË RE BEJSMENTI, STORES/OFFICES  
RESTAURANTS DHE ÇDO MODIFIKIM  
TJETER.






**Giovanni Selmani**  
Sales Representative  
**Direct:**  
**647.500.3875**

**Office: 905.565.9200**  
Fax: 905.565.6677  
E-Mail: [gioselmani@hotmail.com](mailto:gioselmani@hotmail.com)  
[www.rightathomerealty.com](http://www.rightathomerealty.com)

7045 Edwards Blvd., Suite 401  
Mississauga, ON L5S 1X2

